



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr.1520 Prot
9.6.2020

Përmet, më

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin ekonomik “AER“ shpk

Procedura e prokurimit: *Kërkesë për propozim*

Numri i referencës së procedurës: *REF- 57684-05-08-2020*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *“Shërbime riparime, mirëmbajtje automjetesh dhe pjesë këmbimi”.*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): s’ka

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: *çmimi më i ulët X* oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1- **Operatori ekonomik “AER” shpk** me NIPT L71503045D me vlerë të ofertës: 1 972 300 (një milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e treqind) lekë pa TVSH dhe 2 366 760 (dy milion e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë me TVSH.
- 2- **Operatori ekonomik “Eduard Mullaraj” person fizik** me NIPT L78916202I me vlerë të ofertës 1 998 200 (një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e dyqind) lekë pa TVSH 2 397 840 (dy milion e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e dyzet) lekë me TVSH

Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës informojmë **operatorët ekonomik të skualifikuar:**

- **Operatori “Eduard Mullaraj” person fizik**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për ofertën e tij në sistem (SEP) për këtë procedurë prokurimi, rezulton se ky operator ekonomik nuk i plotëson të gjitha kriteret sipas LPP e RRPP dhe kërkesave të AK në DT të kësaj procedurë prokurimi për arsye se:

Operatori ekonomik Eduard Mullaraj person fizik tek Kriteret e veçanta të kualifikimit ka paraqitur Deklaratën e Konfliktit të Interesit (shtojca 7) në të cilën deklaron se nuk ka konflikt

Sheshi “Abdyl Frashëri”, tel.+35581322254, e-mail:info@bashkiapermet.gov.al, www.bashkiapermet.gov.al

interesi. Pas verifikimit të bërë në Regjistrin Kombëtar të Gjëndjes Civile të vitit 2010 bashkëshortja e Z. Eduard Mullaraj, Zj. Elena Mullaraj ushtron njëkohësisht funksionin e anëtares së Këshillit Bashkiak në Bashkinë Përmet.

Sipas ligjit Nr .9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar neni 21 pika 2 theksohet se: “Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, sipas interpretimit të këtij termi në ligjet përkatëse, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie”. Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1 dhe 2 të ligjit Nr .9367, datë 7.4.2005 zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në këtë kuptim të këtij ligji janë bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhore, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.

Oferta te kualifikuara:

- Operatori ekonomik “AER” shpk

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për ofertën e tij në sistem (SEP) për këtë procedurë prokurimi, rezulton se *operatori ekonomik “AER” shpk*, plotëson kriteret e kushteve të përgjithshme, kushteve të veçanta, kërkesat e dokumentacionit të përgjithshëm administrativ, ligjor, teknik dhe ekonomik, sipas kërkesave të AK në njoftimin e kontratës dhe DST të kësaj procedurë prokurimi.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *operatorin ekonomik “AER” shpk me adresë Lagjia Katund i Ri, Rruga “Ali Pashe Gucia”, Pallati nr. 24, Shkalla nr.1, Apartamenti 2, kati i 1, Njësia Administrative Kashar Tiranë* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 1 972 300 (një milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e treqind) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë *Bashkisë Përmet me adresë Sheshi “Abdyl Frashëri” kati i katërt Zyra Juridike*, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës do te veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në **datë 29.5.2020**

Ankesa: JO

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Alma HOXHA

Sheshi “Abdyl Frashëri”, tel.+35581322254, e-mail:info@bashkiapermet.gov.al, www.bashkiapermet.gov.al

